

Vigan Behluli

Vigan Behluli ka përfunduar studimet master në Norfolk State University, në drejtimin e psikologjisë klinike dhe të komunitetit. Ka përfunduar programin specialistik në psikologji klinike, të organizuar nga Universiteti i Bazelit dhe nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Në aspektin psikoterapeutik kryesisht është i angazhuar me popullatë sub-klinike të cilët vuajnë nga simptomat e ankthit dhe humorit të ulur. Beson fuqimisht se metodat më efikase të intervenimit në psikoterapi bazohen në ofrimin e përkrahjes emocionale dhe zbatimin e intervenimeve me qëllim të zbulimit dhe zhvillimit të potencialit vetanak. Për më tepër, metodat më të përshtatshme të intervenimit vijnë si rezultat i bashkëveprimit mes ofruesit të shërbimit të shëndetit mendor dhe klientit.